



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:039257

Datë: 31.07.2024

Numri i dokumentit: 06003692

KPPP.nr.124/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Banka Ekonomike SH.A., me NRB: 70177683, me seli në Prishtinë, sheshi “Nënë Tereza”, kundër debitorëve 1. N.T.SH. “Shalk”, me NRB: 70444706, me seli në Graçanicë, fshati Çagllavicë, dhe 2. L.SH., me vendbanim në Prishtinë, Lagja Marigona, përfaqësuar sipas autorizimit nga Vehbi Halili, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorëve të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.2591/18 të datës 01.10.2018, të Përmbartuesit Privat Isa Gacaferi, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 31.07.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorëve 1. N.T.SH. “Shalk”, dhe 2. L.SH. i paraqitur kundër urdhrit përmbartimor P.nr.2591/18 të datës 01.10.2018, të Përmbartuesit Privat Isa Gacaferi.
- II. MBETET NË FUQI urdhri përmbartimor P.nr.2591/18 i datës 01.10.2018, i Përmbartuesit Privat Isa Gacaferi.

A r s y e t i m

Përmbartuesit Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.2591/18 të datës 01.10.2018, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumenteve përmbartuese Marrëveshjes mbi Pengun Nr. 70/PR, të datës 13.06.2017, e

regjistruar në zyrën për regjistrim të pengut sipas Konfirmimit mbi regjistrimit e pengun R-20170707-329 të datës 07.07.2017; dhe Kontratës mbi Hipotekën LRP.nr.3508/2017, Ref. Nr. 599/2017 të datës 30.06.2017, e regjistruar në Agjencinë Kadastrale të Kosovës sipas Aktvendimit mbi regjistrimin e Hipotekës me numër të protokolit Nr.011-944-1-714/17, të datës 04.07.2017, duke detyruar debitorët që t'ia paguaj kreditorit obligimet kontraktuale në shumën prej 35,758.68 €, me normën e interesit të rregullt si dhe kamatëvonesën 1%, duke përfshirë këtu çdo detyrim tjetër që mund të bëhet i kërkueshëm dhe i arritshëm për pagesë sipas kontratave si më lartë deri në përmbushjen definitive të detyrimit ndaj kreditorit, ashtu që përmbarimi të realizohet përmes bllokimit të llogarive, shitjen e paluajtshmërive së hipotekë lënësve, si dhe të detyrohen që të kompensojnë shpenzimet e procedurës.

Debitorët në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar ka theksuar se përmbarimi për realizimin në të holla caktohet sipas dokumentit të besueshëm siç janë fatura, çeku, kambiali, ndërsa në rastin konkret urdhri është caktuar sipas dokumenteve të besueshme të kreditorit. I ka propozuar gjykatës që të aprovoj prapësimin e debitorëve, të anuloj propozimin për përmbarim si dhe t'ia kompensoj debitorit shpenzimet e procedurës.

Kreditori në përgjigjen në prapësim ka deklaruar se e kundërshton në tërësi prapësimin e debitorëve pasi që të njëjtit nuk e kanë bazuar në ligj, po ashtu prapësimin nuk përmban asnjërin nga shkaqet e parapara me nenin 71 të LPP-së, andaj i njëjti prapësimin e ka ushtruar vetëm për ta zvarritur procedurën. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit si i pabazuar dhe të vazhdohet procedura përmbarimore.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorëve të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorëve është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumentet në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbarim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente përmbaruese dhe i përmbajnë të gjitha

elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 22 dhe 27 të LPP-së, si dhe nenin 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore.

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa sipas nenit 22 par. 1, pika 1.7, përcaktohen dokumentet përmbaruese siç janë: *“...kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit...”* dhe sipas nenin 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore përcaktohet se dokument përmbarues paraqet: *“...kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut...”*. Me nenin 27 par.1 të LPP-së përcaktohet se *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentet përmbaruese përkatësisht Marrëveshjen mbi Pengun Nr. 70/PR, të datës 13.06.2017 dhe Kontratën mbi Hipotekën LRP.nr.3508/2017, Ref. Nr. 599/2017 të datës 30.06.2017, të cilat i plotësojnë kushtet ligjore sipas nenit 21, nenit 22 par.1 pika 1.7, dhe nenit 27 të LPP-së dhe nenit nenin 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, për tu paraqitur si dokumente përmbaruese dhe përbëjnë bazë juridike për caktimin e përmbarimit, pasi që Marrëveshja mbi Pengun Nr.70/PR, e datës 13.06.2017 është regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut sipas Konfirmimit mbi regjistrimit e pengun R-20170707-329 të datës 07.07.2017, dhe Kontrata mbi Hipotekën LRP.nr.3508/2017, Ref. Nr. 599/2017 të datës 30.06.2017, është paraqitur sipas aktit noterial, është regjistruar në regjistrin publik sipas Aktvendimit mbi regjistrimin e Hipotekës me numër të protokolit Nr.011-944-1-714/17, të datës 04.07.2017, si dhe të njëjtat janë paraqitur në kopje të noterizuar.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.124/24, datë 31.07.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.